

Meningjiti dhe Helmimi i gjakut

Meningjiti dhe Helmimi i gjakut janë sëmundje serioze. Ato mund të kapin çdo person, në çdo moshë, por bebet, fëmijët e vegjël dhe të rinjtë janë më shumë në rrezik.

Meningjiti dhe Helmimi i gjakut nuk janë të zakonshme, por ato mund të vdesin brenda disa orësh. Shumë njerëz mbijetojnë, nëse ata diagnostikohen herët, por disa të tjerë mbeten të paafte përgjithmonë, kurse të tjerë mund të duan kohë të shërohen plotësisht.

Një mënyrë e rëndësishme për të mbrojtur familjen tuaj është vaksinimi. Por disa lloje meningjiti nuk mund të parandalohen, kështu që është e rëndësishme të dini mbi sëmundjet dhe shenjat e tyre. Çdo person me meningjit ose helmim gjaku ka nevojë për ndihmë urgjente.

Çfarë është meningjiti?

Meningjiti është ënjtje e cipës së trurit. Format më serioze të meningjitit shkaktohen nga bakteriet.

Çfarë është helmimi i gjakut?

Helmimi i gjakut shkaktohet nga e njëjta bakterie që shkakton meningjitin.

Ju mund të merrni meningjitin dhe helmimin e gjakut në të njëjtën kohë.

Si mund ta mbrojt veten dhe familjen time?

- Një mënyrë e shkëlqyer për mbrojtjen e fëmijëve është sigurimi i vaksinimit kundër meningjitit dhe helmimit të gjakut. Vaksinat i jepen të gjitha bebeve në programin e vaksinimit të fëmijërisë për mbrojtjen kundër llojeve të ndryshme të meningjitit dhe helmimit të gjakut. – **Meningjiti C, Virusi i gripit dhe pneumonisë** dhe meningjiti që shkaktohet nga shytat.
- Çdo person i rritur mbi moshën 65 vjeç mund të vaksinohet kundër meningjitit të pneumonisë. Gjithashtu edhe njerëzit e të gjitha moshave me probleme shëndetësore dhe që vien në rrezik nga sëmundja e pneumonisë mund të vaksinohen kundër saj.
- Vaksina e TB (e cila quhet **BCG**) i jep mbrojtje të veçantë fëmijëve kundër meningjitit TB. Në Irlandë të gjitha bebet e marrin në lindje dhe në Mbretërinë e Bashkuar i jepet bebeve, fëmijëve më të mëdhenj të pavaksinuar dhe të rriturve që janë në rrezik të lartë të TB. Kjo mund të jetë për arsyen se ku jetojnë apo kanë jetuar në të kaluarën, ku punojnë ose sepse prindërit ose gjyshërit vijnë nga një vend me përqindje të lartë TB-je.
- Udhëtarët ndërkombëtarë mund të kenë nevojë për një vaksinë të veçantë 'kuadrivalente' meningjiti. Kjo të mbron nga meningjiti dhe helmimi i gjakut që shkaktohen nga katër viruse të ndryshme: **Men A, C, Y dhe W135**. Një certifikatë e vlefshme, që tregon që ti e ke bërë vaksinën 'quadrivalent ACWY meningococcal' brenda tre viteve të fundit, tani është një kërkesë për vizë për udhëtarët dhe punëtorët sezonalë që hyjnë në Arabinë Saudite. Ju duhet të bëni vaksinën dhe të merrni një certifikatë nga doktori ose një klinikë udhëtimi të paktën tre javë para largimit për në Arabinë Saudite. Nëse udhëtoni me fëmijë nën moshën 2 vjeç, ju duhet ta bëni këtë tre muaj para udhëtimit, sepse fëmijët kanë nevojë për dy vaksinime që jepen tre muaj larg nga njëra-tjetra.
- Njerëzit që udhëtojnë për në Afrikë kanë nevojë për vaksinën kuadrivalente gjithashtu. Klinika e doktorit ose ajo e udhëtimit mund t'ju tregojë se cilat shtete janë të prekura dhe mund të caktojnë që ju ta merrni vaksinën nëse nevojitet.

Mos harroni, ka disa lloje meningjiti dhe helmimi të gjakut, të cilat nuk mund të parandalohen. Shumica e meningjiteve në MB dhe Irlandë shkaktohen nga virusi **MenB**, dhe nuk ka vaksinë që ta parandalojë atë. Prandaj është e rëndësishme të dini shenjat e meningjitit dhe helmimit të gjakut me qëllim mbrojtjen tuaj dhe të familjes tuaj.

Cilat janë shenjat e meningjtit dhe helmimit të gjakut?

Mësoni shenjat Ju lutemi mbajeni këtë për referim

- Meningjiti dhe helmimi i gjakut mund të jenë të vështira për t'u dalluar fillimisht. Shenjat mund të paraqiten në çdo radhë, por në fillim shenjat janë zakonisht ethe, vjellje, dhimbje koke dhe mos ndjereje mirë si shumë sëmundje të lehta. **Shenjat e "Flamurit të kuq"** ➤ shpesh paraqiten më herët se shenjat e meningjtit si mpirja dhe mos dëshirimi i dritës dhe para **shenjave më serioze** ●
- Jo çdo person i ka të gjitha këto shenja.
- Helmimi i gjakut mund të ndodhë me ose pa meningjit.

	Helmimi i gjakut	Meningjiti
Ethe dhe/ose vjellje 		
Dhimbje të forta koke 		
Dhimbje gjymtyre/nyje/muskuli (ngandonjëherë dhimbje stomaku/diarre) 		
Duar dhe këmbë të ftohta /dridhje 		
Lëkurë e zbehtë ose lara-lara 		
Marrje fryme me shpejt/bllokim frymëmarrje 		
Puçra (në çdo vend të trupit) 		 Jo të pranishme në të gjitha rastet
Mpirje e qafës 		 Më pak të zakonshme te fëmijët e vegjël
Mos dëshirim i dritave të forta 		 Më pak të zakonshme te fëmijët e vegjël
Shumë i përgjumur/ i këputur/ vëshirësi zgjimi 		
I turbulluar/ marrje mendsh 		
Dridhje të pakontrollueshme mund të paraqiten 		

A ka shenja të veçanta që mund të dallohen tek bebet?

Po. Shenja të tjera që duhet të vini re tek bebet përfshijnë:

- Pjesë e butë e dalë ose e fryrë në kokën e bebit
- Kundërshtim i ushqimit
- Nervoz kur merret në krahë dhe me qarje me zë të lartë ose rënkuese
- Trupi i mpirë me lëvizje të pakontrolluara ose i këputur dhe pa jetë


Bebet mund të sëmuren shpejt, kështu që i kontrolloni shpesh.

A i kanë të tjerët të gjitha këto shenja të meningjitit dhe helmimit të gjakut?

Jo. Jo çdo person i ka të gjitha shenjat dhe ato mund të paraqiten në çdo radhë. Nëse ka acarim lëkure, ju duhet të bëni testin e Gotës. Shtypni një gotë kundrejt acarimit. Nëse acarimi nuk zhduket dhe ju e shikoni atë nga xhami, kërkon ndihmë menjëherë.



Acarimi i lëkurës mund të jetë më i vështirë që të dallohet mbi lëkurë të errët. Kështu që shikoni për puçrra nëpër trup, veçanërisht në zonat e zbehta siç janë pëllëmba e dorës ose shputa e këmbës. Gjithashtu shikoni mbi stomak, brenda kapakëve të syrit ose qiellzën e gojës.



Vini re. Një person shumë i sëmurë ka nevojë për ndihmë mjekësore edhe nëse ka pak puçrra, një acarim që zbehet ose edhe nëse nuk ka acarim fare.

Çfarë duhet të bëj nëse mendoj se dikush ka meningjit ose helmim gjaku?

Një person me meningjit ose helmim gjaku mund të sëmuret rëndë shumë shpejt. Kështu që nëse dikush është i sëmurë shikoni rregullisht shenjat. Nëse mendoni se mund të jetë meningjit ose helmim gjaku kërkon ndihmë mjekësore menjëherë.

Linja Falas 24 orëshe e Ndihmës së Fondacionit të Kërkimeve të Meningjitit

MB - **080 8800 3344**

Republika e Irlandës - **1800 41 33 44**

Zyra Qendrore:

Midland Way

Thornbury

Bristol

BS35 2BS

Tel: 01454 281811

Zyra në Skoci:

28 Alva Street

Edinburgh

EH2 4PY

Tel: 0131 510 2345

Zyra në Irlandën

Veriore:

71 Botanic Avenue

Belfast

BT7 1JL

Tel: 028 9032 1283

Zyra në Republikën e

Irlandës:

63 Lower Gardiner

Street

Dublin 1

Tel: 01 819 6931

Një shoqatë bamirëse e regjistruar në Angli dhe Uells me numër 1091105, në Skoci me nr. SC037586, dhe në Irlandë CHY 12030.

© Fondacioni i Kërkimeve të Meningjitit 2007

Translated by

K International plc

The Multilingual Solutions Company

